

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit:	04/47
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.:	1795-2/2022
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	2
Data Datum Date:	28.10.22
Djalose PRISHTINE/A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Auditimit të Brendshëm - Departman Unutrašnje Revizije - Internal Audit Department

DATË/A:	28.10.2022
REFERENC-Ë:	47 /2022
PËR/ZA/TO:	Z. Mehmet Ballazhi, Kryetari i Komunës se Hanit të Elezit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Ruhan Kadriu, Drejtor i DAB-it
CC:	Z. Hekuran Murati , Ministër i MFPT
NGA/OD/FROM:	Z. Kosum Aliu Udhëheqës i Ekipit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Final i AB në Komunën Hani i Elezit

Të nderuar Zotërinj,

Të bashkangjitur keni Raportin Final të Auditimit të kryer, bashkë me objektivat kryesore për dhënien e mendimit lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm, planifikimin dhe administrimit e buxhetit në komunën e Hani Elezit.

Në shkresën për draft raport i dërguar me datë 11.10.2022 ju jeni informuar se keni mundësi/një afat prej 10 ditëve nga data e lëshimit të draft raportit për të dhanë komentet tuaja.

Me që në deri më tani nuk kemi marr asnjë koment nga ana juaj, konsiderojmë se ju jeni pajtuar me raportin dhe po ua dërgojmë raportin final të auditimit të brendshëm.

Shpresojmë që rekomandimet tona jenë praktike dhe të zbatueshme për ju, presim të punojmë me ju për të siguruar zbatimin e tyre.

Auditimi është kryer nga ekipi i auditimit:

Kosum Aliu, Udhëheqës i ekipit të auditimit
 Pakizete Musliu, Anëtare e auditimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Auditimit të Brendshëm
Departman Unutrašnje Revizije - Internal Audit Department

RAPORTI FINAL
I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

FUNKSIONIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM, PLANIFIKIMI DHE
ADMINISTRIMI I BUXHETIT NË KOMUNËN E HANI ELEZIT

Tetor, 2022

BAZUAR NË PLANIN VJETOR

Në bazë të Planit Vjetor të Departamentit të Auditimit të Brendshëm

ORGANIZATA E AUDITUAR :

Komuna e Hani Elezit

PROGRAMI/PROJEKTI/SISTEMI OPERACIONAL:

Funksionimi i Komunës së Hani Elezit

LLOJI I AUDITIMIT :Sistemet/Pajtueshmëria
Përputhshmëria/krahasimi/financiar,**FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT:**

Janar – Dhjetor 2021 dhe 2022 deri në ditën e auditimit

KOHËZGJATJA E AUDITIMIT :Data e fillimit; 22.08.2022
Data e draft raportit: 11.10.2022
Data e Raportit Final: 28.10.2022**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TE BRENDESHEM****UDHËHEQËSI I EKIPIT TË AUDITIMIT:**

Kosum Aliu

ANËTARËT E EKIPIT TË AUDITIMIT:

Pakizete Musliu

Përmbledhja Ekzekutive	4
1. Hyrje	7
2. Qëllimi dhe fushëveprimi.....	7
2.1 Qëllimi i auditimit.....	7
2.2 Objektivat e auditimit.....	8
2.3 Fushëveprimi.....	8
3. Të gjeturat dhe rekomandimet	8
3.1 Funkzioni i Komunës ne pajtueshmëri me legjislacionin	9
3.1.1 Struktura organizative e komunës dhe Funkcionimi i K. Komunal.....	9
3.2 Kontrollat e brendshëm në Administrimin e Komunës.....	9
3.3 Planifikimi i buxhetit dhe realizimi i shpenzimeve	10
3.3.1 Planifikimi i buxhetit	10
3.3.2 Realizimi i shpenzimeve	13
3.3.3 Paraja e imët	14
3.3.4 Shpenzimet për dreka zyrtare	15
3.3.5 Vonesa ne pagesat e faturave	15
3.3.6 Subvencionet	15
3.3.7 Menaxhimi i kontratave	17
3.4 Resurset humane, personeli.....	18
4. Konkluzionet	19
5. Plani i Veprimit	19
6. Faleminderit.....	19

Aneksi I Veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi paraprak

Aneksi II - Të gjeturat, rekomandimet dhe komentet e menaxhmentit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIV

Auditimi i kryer në komunën e Hani të Elezit ka për qëllim që t'i ndihmojë menaxhmentit të komunës në forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për menaxhimin e rrezikut në administrimin e sistemit mbikëqyrës në zbatimin e rregullave për ngritjen dhe zhvillimin kapaciteteve, sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë për zhvillim ekonomik, shoqëror dhe social të komunës.

Menaxhimi efikas dhe transparent i fondeve publike të destinuara për zhvillim shoqëror – ekonomik dhe arritjen e objektivave të komunës, duhet të jetë në pajtueshmëri me ligjet, rregulloret, procedurat dhe udhëzimet, planet e Komunës dhe organizatat e saja vartëse, për të ngritur efikasitetin e menaxhimin e kontrollit të brendshëm.

Objektivat e auditimit janë caktuar në bashkëpunim me menaxhmentin e komunës dhe janë të bazuara në analizën dhe vlerësimin e rrezikut për menaxhim të veprimeve për proceset e administrimit të fondeve të komunës me qëllim të realizimit të objektivave dhe vlerësimin të sistemeve të kontrollit sa janë adekuate për menaxhimin e rrezikut në këto procese.

Për kryerjen e auditimit ekipi i auditimit ka rishikuar, kontrolluar, verifikuar dhe testuar dokumente të ndryshme që ndërlidhen me procedurat e përgatitjes dhe menaxhimit të veprimeve në proceset e administrimit të komunës (në kuadër të objektivave të përcaktuara).

Gjatë procesit të auditimit, ekipi i auditimit ka identifikuar të gjeturat:

- Me Statutin e komunës Hani i Elezit është rregulluar organizimi dhe funksionimi i organeve të vetëqeverisjes lokale në komunë;
- Kryetari i komunës ka sjellë rregulloren mbi organizimin e brendshëm të komunës së Hani i Elezit me datë 31.10.2012, kërkohet të azhurnohet;
- Kuvendi komunal Hani i Elezit përbëhet prej 15 anëtarëve. Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal marrin kompensim për punën e tyre në Kuvendin Komunal dhe komisionet e tij.
- Kuvendi Komunal gjatë vitit 2021 ka mbajtur 12 takime të rregullta, gjatë këtij viti janë mbajtur 8 takime të rregullta;
- Nuk janë krijuar raporte periodike për paraqitje e realizimit të objektivave dhe për sfidat e paraqitura nga udhëheqësit e drejtorive dhe njësitëve të Komunës;
- Komuna nuk përgatit apo përdorë një sistem të brendshëm “baza e të dhënave” për menaxhimin të realizimit të shpenzimeve;
- Realizimi i shpenzimeve sipas kodeve ekonomik, krahasuar me kërkesat buxhetore të planifikuara janë tejkaluar (mbi 50%), të paraqitura në formën e PCF4;

- Në të gjitha shpenzimet e realizuara, mungojnë kërkesa për inicimin e furnizimeve/shërbimeve nga njësit apo zyrtarët kërkuar, aprovuar nga udhëheqësi më i lartë administrativ;
- Faturat e pranuar për shërbime dhe furnizime janë arkivuar me vonës (19 lënde nga mostra e testeve);
- Ekzistojnë fatura të arkivuara pa datë (4 lëndë nga mostrat e përzgjedhur);
- Mungon dokumenti i konfirmimit të furnizimeve dhe shërbimeve nga menaxheri i kontratës, në të gjitha lëndët;
- Plani i menaxhimit të kontratës nuk janë bashkangjitur lëndëve të shpenzimit;
- Lëndëve të shpenzimeve nuk iu janë bashkangjitur vendimet e miratuara për menaxhimin e kontratave nga udhëheqësi më i lartë administrativ (20 lëndëve nga mostrat për testim);
- Në raportin e pranimit në formularin e urdhër blerjes mungon përshkrimi i plotë për mallra, shërbimet dhe punën e pranuar sipas kushteve të specifikuara;
- Pranimi i mallrave dhe shërbimeve është bërë përmes komisionit prej tre anëtarësh, me vendim nga Zyrtari i Lartë Administrativë;
- Shpenzimet për dreka zyrtare pa arsyeshmëri të plotë të shpenzimit;
- Ka vonës të mbylljes së obligimit, ekzekutimit të pagesave;
- Shpenzimi i parasë së imtë është shfrytëzuar në disa raste për shpenzimet që mundë të planifikohen dhe mundë të bëhen përmes procedurës së blerjes;
- Janë bërë ndarjet e subvencioneve pas shpalljes publike që janë publikuar në ueb faqen e komunës, media sociale.
- Komuna nuk ka përgatitur Planin vjetor të mbështetjes financiare të Organizatave Jo Qeveritare; (OJQ);
- Nuk është përgatitur Raporti vjetor për projektet e financuara, dhe as nuk ishte publikuar në web faqen e komunës lista e përfituesve;
- Janë nxjerr vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve nga kryetari i komunës;
- Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave ka nxjerr listën e përfituesve të subvencioneve. Subvencionet janë ndarë për zhvillim ekonomik, për bujqësi, kulturë rini dhe sport, arsim (bursa studentëve), mbështetje për lehonat;
- Përfitues të subvencioneve kanë qenë të ndryshëm si Organizata joqeveritare, individ, biznese private;
- Në aplikacion të kërkuar të subvencionit është paraqit qëllimi për aplikim;
- Në të gjitha rastet e testuar është nxjerr Vendimi për ndarje të subvencioneve përfituesit;
- Nuk janë monitoruar përfituesit e subvencioneve nga Komuna;
- Dosjet janë të radhitura po jo në baze të listës kontrolluese për të menaxhuar dhe azhurnuar dosjen e personelit.

Në bazë të gjeturave të lartë përmendura, ne kemi formuar mendimin dhe opinionin tonë në lidhje me përshtatshmërinë dhe efektivitetin proceseve të audituara, procedurave dhe sistemin e kontrolleve të brendshme në komunën e Hani të Elezit, në gjendjen aktuale.

Vlerësimi	Përshkrimi	Niveli i shqetësimit
Nevojitet për përmirësim të dukshëm	Dobësi të ndjeshme të kontrollit janë vërejtur të cilat mund të bëjnë menaxhmentin objekt të ekspozimit material. Megjithëse disa kontrolle lehtësuese janë në funksion, kërkohet përmirësim i dukshëm për t'u mbrojtur si duhet nga një ekspozim i tillë.	Shkak për shqetësim

Zbatimi i rekomandimeve nga auditimi i mëhershëm, na jep siguri nga menaxhmenti që kontrollet e brendshme kanë ngritë nivelin e përgjegjësisë së tyre.
Nga auditimi brendshëm paraprak është dhënë 1 (një) rekomandim.

Rekomandimi pjesërisht është zbatuar.

Zbatimi komplet i rekomandimeve ulë rrezikun e vazhdueshme të pranisë së mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në efikasitet e vazhdueshëm të kontrolleve dhe në ruajtjen e parasë publike.

Për veprimet që janë ndërmarr për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi paraprak, janë të bashkangjitur në tabelën aneksi nr.1.

1. HYRJE

Auditimi është kryer sipas Planit vjetor të Departamentit të Auditimit për vitin 2022 në mbështetje të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Auditimi është kryer për të vlerësuar kontrollin e brendshëm në funksionimin e komunës:

- Efikasitetin e sistemeve të kontrollit të brendshme;
- Krijimin e kontroleve të brendshme;
- Delegimin e funksioneve në përputhje me rregullat dhe procedurat e Kontrollit;
- Funksionimin e përgjithshëm në përputhshmëri me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Menaxhmenti i komunës së Hani Elezit përmes administrimit të fondeve të komunës duhet të ofroj sigurimin e një shërbimi profesional për arritjen e objektivave në zhvillimin, përparimin dhe ngritjen e vlerave së shërbimeve në komunë.

Menaxhimi i suksesshëm arrihet përmes përmirësimit të cilësisë së analizave që përdoren në administrim, koordinim të politikave, strategjive, transparencës në proces, rritjen e efikasitetit të kryerjes së shërbimeve, avancimin/modernizimin e sistemeve në ofrimin e shërbimeve dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale.

Për kryerjen e auditimit në komunën e Hanit të Elezit është shfrytëzuar legjislacion në vijim:

- Ligji për vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L-040;
- Ligji për financat e pushtetit lokal Nr. 03/L-049;
- Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe 2022;
- Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048;
- Rregullore për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere;
- Rregullore e MF nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Rregullore e MF Nr. 02/2017 për alokimin e fondeve;
- Rregullore e MAPL Nr. 02/2017 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave;
- Rregulla financiare e MF nr. 01/2013 – shpenzimi i parave publike;
- Rregullore e MF Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore;
- Rregullore e MAP Nr. 03/2011 mbi dosjet dhe regjistrin qendror të nëpunësve civil;
- Rregullore për organizimin e brendshëm të administratës komunale (Hani i Elezit);

2. QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI

2.1 Qëllimi

Qëllimi i auditimit të brendshëm në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit për funksionimin e komunës të Hani të Elezit, është analizimi, hulumtimi, verifikimi i procedurave dhe kontrolleve të brendshme që i zbaton menaxhmenti për t'u siguruar se komuna ka organizuar dhe vendosur kornizën e kontrolleve të qëndrueshme në procesin e administrimit të fondeve për zhvillim shoqëroro – ekonomik të komunës për realizimin e misionit dhe objektivave të caktuara. Komuna dhe menaxhmenti i sajë duhet të jep një siguri të arsyeshme për çështje publike për ofrimin e shërbimeve efikase në interes të qytetarëve.

2.2 Objektivat e auditimit

Në bazë të analizës së rrezikut të sistemit të kontrollit të brendshëm në komunën e Hani të Elezit dhe në pajtim me marrëveshjen e arritur me menaxhmentin gjatë takimit fillestar, janë përcaktuar objektivat e auditimit nëse:

- Komuna e Hani i Elezit funksionon në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi;
- Komuna e Hani Elezit ka krijuar kontroll të brendshëm adekuate për administrimin e saj;
- Planifikimi i buxhetit dhe realizimi i shpenzimeve
- Resurset humane-personeli.

2.3 Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i auditimit është përqëndruar në funksionimin e komunës në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara për realizimin e misionit dhe objektivave të saja të lartë cekura për periudhën Janar-Dhjetor 2021 dhe për vitin 2022 deri në ditën e përfundimit të auditimit. Testimi është përqëndruar në komunën Hani të Elezit.

3. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET

3.1 Funksionimi i Komunës në pajtueshmëri me legjislacionin

3.1.1 Struktura organizative e komunës dhe Funksionimi i Kuvendit Komunal

Sipas autorizimeve sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, komuna e Hani të Elezit me 2/3 e ansambleistëve, ka miratua “Statutin e komunës së Hani të Elezit me datë 25.10.2018” me të cilin rregullohet funksionimi i komunës.

Në mbështetje të Ligjit për vetëqeverisje lokale, me Statutin e komunës së Hani të Elezit është rregulluar organizimi dhe funksionimi i organeve të vetëqeverisjes lokale në këtë komunë.

Duke u mbështetur në aktet ligjore, Kryetari i komunës ka sjellë rregulloren mbi organizimin e brendshëm të komunës së Hani të Elezit me datë 31.10.2012.

Organizimi i brendshëm ka për qëllim organizimin e njësisë organizative dhe funksionimin e tyre. Për funksionim më të suksesshëm të qeverisjes komunale në realizimin e kompetencave dhe kryerjen e detyrave janë formuar kabineti i kryetarit, departamentet dhe njësitë tjera organizative në kuadër të departamenteve dhe Komunës.

Që nga viti 2012 kur është nxjerr rregullorja mbi organizimin e brendshëm të komunës nuk ka pasur asnjëherë rifreskim/azhurnim të rregullores, në fakt ka pasur ndryshime dhe lëvizje të strukturës organizative të komunës jashtë strukturave ekzistuese, kjo tregon domosdoshmërinë e azhurnimit sa më të shpejt të Rregullores mbi organizimin e brendshëm të komunës për përshtatjen me funksionimin dhe nevojat aktuale të komunës së Hani të Elezit.

Fushëveprimi i punës së departamenteve, përshkrimi detal i punëve bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore përcaktohet nëpër sektorë me vendim të Kuvendit Komunal.

Çdo departament komunal udhëhiqet nga drejtori të cilin e emëron dhe shkarkon kryetari i komunës.

Për funksionimin e strukturës organizative të komunës është miratuar buxheti për vitin 2021 dhe 2022 me stafin prej 239, aktualisht janë 221 staf (stafi politik dhe stafi civil) duke përfshirë personelin e shëndetësisë primare dhe personelin e arsimit para universitar.

Kuvendi komunal Hani i Elezit përbëhet prej 15 anëtarëve. Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal marrin kompensim për punën e tyre.

Kuvendi Komunal gjatë vitit 2021 ka mbajtur 12 takime të rregullta, gjatë këtij viti (2022), janë mbajtur 8 takime të rregullta.

Për çdo seancë të mbajtur, Kuvendi Komunal ka dokumentacionin mbështetës: rendin e ditës, ftesën për pjesëmarrje në takim për anëtarët e Kuvendit Komunal, procesverbalin nga seanca, listën e pjesëmarrësve në takim me nënshkrime dhe e nënshkruar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal. Nga diskutimet në takime janë dhënë propozime dhe janë marrë vendime që janë të bashkangjitura me procesverbalin e çdo takimi.

Mos azhurnimi i rregullores mbi organizimin e brendshëm të komunës ndikon në suksesin e qeverisjes komunale, realizimin e kompetencave, kryerjen e detyrave, arritjen e objektivave dhe misionit të komunës.

Konkluzion:

Me qëllim të funksionalizimit të kontrolleve të brendshme në Komunën e Hani të Elezit, rregullorja mbi organizimin e brendshëm të komunës duhet të harmonizohet/përshtatet me funksionet dhe nevojat aktual të komunës.

Rekomandim Nr.1

Komuna të bëjë azhurnimin e rregullores mbi organizimin e brendshëm të komunës.

3.2 Kontrollat e brendshme në Administrimin e komunës

Për t'u siguruar se kontrolli i brendshëm është krijuar dhe po funksionon si duhet në tërë zinxhirin e llogaridhënies me qëllim arritja e objektivave (ambienti i kontrollit, vlerësimi i rrezikut, aktiviteti i kontrollit, komunikimi dhe monitorimi) raportimi në hierarkinë vertikale dhe horizontale është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për menaxhmentin.

Udhëheqësit drejtorive dhe njësite, në pajtim me udhëzimet e kryetarit, statutin, ligjet dhe vendimet e komunës duhet përgatisin raporte për paraqitjen e realizimit të objektivave dhe për sfidat e paraqitura. Duhet të raportojnë rregullisht te kryetari për çështjet në kuadër të përgjegjësisë të tyre me të gjitha informatat (me fokus rezultatet e arritura) e nevojshme për vendim marrje.

Nuk kemi gjetur se janë përgatitur raporte periodike nga udhëheqësit e drejtorive dhe njësite të Komunës

për kryetarin, strukturat hierarkike për paraqitjen e realizimit të objektivave dhe sfidat e paraqitura. Është përgatitë regjistri rreziqeve, përshkrimi i proceseve, mirëpo mungesa e përgatitjeve të raporteve periodike në forme të shkruar nga udhëheqësit e drejtorive dhe njësite të Komunës mundë të ndikoj që

te aktivitetet e kontrollit të mos ketë komunikim më të mirë të strukturuar për rezultatet e arritura dhe monitorim të rezultateve të punës.

Janë përgatitur vetëm raportet periodike financiare për periudhat tre mujore.

Komuna e Hani të Elezit përveç SIMFK-së që përcjellë buxhetin dhe shpenzimet, duhet të përgatit dhe mirëmbaj edhe një sistem të brendshëm "baza e të dhënave" apo forme tjetër të (platformë, programit, për të përcjellore ekzekutimin e shpenzimeve, për ofrimin e informatave të sakta, të plota dhe në kohë për menaxhmentin.

Komuna nuk përgatit apo përdorë një sistem të brendshëm "baza e të dhënave" për menaxhimin të realizimit të shpenzimeve.

Mungesa e përdorimit të një data baze të brendshëm mundë të ndikoj në përgatitje e raporteve jo të saktë, jo të plotë dhe në vonesë të informimit te menaxhmenti lartë.

Konkluzion :

Të gjeturat e auditimit tregojnë se nuk funksionojnë si duhet kontrollat e brendshëm. Duhet të ngritët niveli i funksionimit të kontrollit të brendshëm në komunikim më të mirë të strukturuar për rezultatet e arritura dhe në monitorimin e mirëfilltë të rezultateve për punë.

Rekomandimi Nr.2

Kryetari i komunës në të ardhmen të siguroj, fuqizoj zbatimet e funksionimeve të kontrolleve të brendshme në të gjitha proceset.

3.3 Planifikimi buxhetit dhe realizimi i shpenzimeve

3.3.1 Planifikimi buxhetit

Me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (LMFPP), Ligjin për financimin e pushtetit lokal (LFPL) përcaktohet financimi i komunave.

Bazuar në ligjet e cekura, komuna Hani i Elezit ka përgatitur buxhetin për vitin 2021 dhe 2022. Për përgatitjen e buxhetit, dokument bazë është Korniza afatmesme buxhetore (KAB), e cila pasqyron caqet e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.

Parimet, kriteret dhe formulat e aplikuara për ndarjen e grandit shtetëror për financimin e komunës për vitin 2021 bazohen në Ligjin për financimin e pushtetit lokal dhe Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Kufijtë e financimit për periudhën 2021-2023 janë lejuar nga Komisioni i granateve dhe janë miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Burimet e financimit komunal janë nga grandet qeveritare/ndarjet buxhetore për komuna dhe të hyrat vetanake.

Nga kategoria e graveve qeveritare komunat pranojnë grave operative nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (grandet e përgjithshme, grandet specifike për arsim, grandet specifike për shëndetësi), grandet dhe transferet tjera (në rastet e shtimit të kompetencave të komunave) dhe grandet e jashtëzakonshme.

Për shpërndarjen e graveve për vitin 2021 dhe 2022 në komunën e Hani Elezit janë zbatuar kriteret dhe formulat themelore të përcaktuara me Ligjin për financimin e pushtetit lokal dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Kërkesat buxhetore për strukturat organizative janë përgatitë brenda kufijve buxhetor të programeve të komunës për shpenzimet operative dhe janë regjistruar në sistemin e zhvillimit dhe menaxhimit të buxhetit (SZHMB) për përgatitjen e buxhetit.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ndarjet buxhetore janë planifikuar sipas kërkesave për shpenzime në zërat e caktuar të shpenzimeve, sipas kërkesave buxhetore në formën PCF4. Kërkesat për ndarje buxhetore janë përgatitë nga zyra për buxhet dhe financa në diskutim me zyrtarët e programeve dhe nën programeve buxhetore sipas analizave për nevojat buxhetore.

Realizimi i buxhetit total i shprehur në përqindje sipas kategorive ekonomike Janar-Dhjetor 2021

Kategoritë Ekonom. Te shpenzimeve	Buxheti 2021	Realizimi i buxhetit Janar-Dhjetor 2021	% e realiz. të Buxh. në raport me buxhetin
Paga dhe shtesa	1,645,045.11	1,645,045.11	100.00%
Mallra dhe shërbime	355,065.39	348,741.08	98.22%
Shpenzime komunale	65,100.00	64,899.87	99.69%
Subvencione dhe transfere	80,290.00	72,465.00	90.25%
Shpenzime kapitale	533,593.31	503,312.41	94.33%
TOTALI	2,679,093.81	2,634,463.47	98.33%

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin fiskal 2021 ka qenë në shumë prej 2,679,093.81 €, prej tyre shpenzimi është në lartësi prej 2,634,463.47 € apo 98.33%, ndërsa mjetet e pashpenzuara (mjetet e zotuar dhe të lira) janë në shumë prej 44,630.34 € apo 1.67%.

Buxheti nga financimi i huamarrjes në arsim (fondi 04) ka qenë në shumë prej 6,156.63€, prej tyre mjete janë shpenzuara në shumë prej 6,156.63 € apo 100.00 %.

Buxheti nga grantet qeveritare (fondi 10) ka qenë në shumë prej 2,260,149.48 €, prej tyre janë shpenzuar në shumë prej 2,253,664.36 € apo 99.71%, kurse në suficit kanë mbet shuma prej 6,485.12 € apo 0.29 %.

Buxheti nga të hyrat vetanake 2020 (fondi 21) ka qenë buxheti fillestar në shumë prej 288,624.00 €, prej tyre mjete janë shpenzuara në shumë prej 253,181.28 € apo 87.72 % .

Buxheti nga të hyrat vetanake të bartura 2020 (fondi 22) ka qenë në shumë prej 57,779.88 €, prej tyre mjete janë shpenzuara në shumë prej 57,001.74 € apo 98.65 %, mjetet që janë bartë në vitin vijues janë në shumë prej 778.14 € apo 1.35%.

Buxheti nga donacionet ka qenë në shumë prej 66,383.82 €, janë shpenzuara mjete me shumë prej 64,459.46 € apo ne përqindje 97.10 %, mjete të pashpenzuara në shumë prej 1,920.36 € apo 2.90 %, janë bartë në vitin 2022 .

Realizimi i buxhetit total i shprehur në përqindje sipas kategorive ekonomike Janar–Qershor 2022

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Buxheti 2022	Realizimi janar-qershor 2022	%
Paga dhe shtesa	1,756,083.00	845,636.78	48.15%
Mallra dhe shërbime	385,975.00	97,003.58	25.13%
Shpenzime komunale	67,700.00	29,238.28	43.19%
Subvencione dhe transfere	80,000.00	28,532.00	35.67%
Shpenzime kapitale	455,000.00	49,999.89	10.99%
Rezervat	15,000.00	-	0.00%
TOTALI	2,759,758.00	1,050,410.53	38.06%

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin fiskal 2022 është në shumë prej 2,759,758.00 €, buxheti i realizuar për periudhën Janar Qershor 2022 është në shume prej 1,050,410.53 € apo 38.06 %.

Planifikimi i mirë, analizat dhe vlerësimi adekuat i nevojave e komunës se Hani i Elezit paraqet kontroll për rregullimin e ndarjeve buxhetore.

Për paraqitjen e raporteve për shpenzime më të sakta dhe të drejtë duhet të bëhet ekzekutimi i shpenzimeve sipas kodeve ekonomike që janë të planifikuara me buxhet.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit për përgatitje buxhetore realizimin e buxhetit sipas kodeve ekonomike, për të gjitha strukturat organizative të komunës, mund të konstatojmë se nuk është

bërë një planifikim i drejt dhe real buxhetit në harmoni me kërkesat buxhetore sipas kodeve buxhetore.

Në Komunën e Hani të Elezit, realizimi i buxhetit, shpenzimet gjatë vitit 2021 të disa kode ekonomike (13310, 13320, 13440, 13470, 13501, 113509, 13640, 14010, 14032, 14310, 14320, 21200, 31230, 31250, 31690) janë tejkaluar, krahasuar nga kërkesat buxhetore sipas kodeve ekonomike të planifikuara, të paraqitura në formën e PCF4.

Mos vlerësimi adekuat i nevojave të kërkesave buxhetore sipas kodeve ekonomike ndikon tejkalime në ekzekutimin e buxhetit dhe në mos sigurimin e fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Konkluzion:

Komuna e të ngrite nivelin e kontrollës së brendshme, në vlerësim më adekuat të nevojave apo kërkesave buxhetore që të mos shkaktohen tejkalime në ekzekutimin e buxhetit sipas kodeve ekonomike.

Rekomandim Nr.3

Planifikimi i buxhetit të bëhet me një analizë, vlerësim më adekuat me nevojat të komunës dhe në harmoni me kodet ekonomike me qëllim të pasqyrimit të saktë për të gjitha shpenzimet sipas rregullave financiare.

3.3.2 Realizimi i shpenzimeve

Realizimi i mjeteve buxhetore bëhet në mbështetje të LMFPP dhe Rregullës financiare të MF Nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike. Rregulli financiar përcakton mënyrat se si shpenzohen paratë publike në pajtim me LMFPP.

Menaxhmenti i Komunës së Hani të Elezit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.

Shpenzimet duhen të monitorohen përmes ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarëve, pjesëmarrës në procesin e shpenzimeve, linjave të raportimit, përgatitjes së pasqyrave financiare të shpenzimeve, barazimit të raporteve financiare të shpenzimeve në baza periodike me Thesarin, komunikimit zyrtar dhe vëzhgimit fizik të mallrave dhe shërbimeve për nevojat e komunës.

Arsyeshmëria e shpenzimeve bëhet duke iu bashkangjitur dosjes dokumentacionin e kompletuar. Për regjistrimin e të gjitha shpenzimeve përmes të cilit përcillet ekzekutimi i shpenzimeve, për informata të plota duhen të bëhen regjistrimet adekuate në programe.

Në procesin e shpenzimeve duhet të bëhet ndarja adekuate e detyrave dhe përgjegjësive. Komuna e Hani të Elezit detyrat i ka ndarë në pajtim me Procedurën për Menaxhimin e Qasjes së Përdoruesve në SIMFK.

Bazuar në Rregulloren 01/2013 MF - Shpenzimi i Parave Publike, organizatat buxhetore janë të obliguar për regjistrim të shpenzimeve në SIMFK me dokumente komplete.

Nga dokumentacioni i testuar 47 mostra të përzgjedhura për shpenzimet e realizuara për vitin 2021 dhe 2022 me vlerë prej 318,931.29 €, kemi gjetur:

- Për shpenzimet e realizuara, mungojnë kërkesat me arsyetim më të plotë apo të detajuar për inicimin e furnizimit/shërbimit nga njësia apo zyrtari kërkuar, i aprovuar nga udhëheqësi më i lartë administrativ (në të gjitha lëndët);
- Faturat e pranuar për shërbime dhe furnizime janë arkivuar me vonësë (19 lëndë nga mostra e testuar);
- Ekzistojnë fatura që janë arkivuar por pa datë (4 lëndë nga mostrat e përzgjedhur);
- Mungon dokumenti i konfirmimit nga menaxheri i kontratës (në të gjitha lëndët);
- Plani i menaxhimit i kontratës për shpenzime nuk janë bashkangjitur lëndëve;
- Lëndëve të shpenzimeve nuk iu janë bashkangjitur vendimet e miratuara për menaxhimin e kontratave nga udhëheqësi më i lartë administrativ (20 lëndëve nga mostrat për testim);
- Në raportin e pranimit, te formulari i urdhër blerjes mungon përshkrimi i plotë për mallra/shërbimet dhe punën e pranuar sipas kushteve/kërkesave të specifikuara;
- Pranimi i mallrave dhe shërbimeve është bërë përmes komisionit prej tre anëtarësh, me vendim nga Zyrtari i Lartë Administrativë.

Konkluzion:

Duhet të ngritet niveli i funksionimit të kontrollit të brendshëm në regjistrimin, kompletimin e lëndëve për shpenzimet sipas Rregullave Financiare.

Rekomandim Nr. 4

Të bëhet regjistrimi dhe kompletimi i të gjitha lëndëve për shpenzimet e realizuara buxhetore në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

3.3.3 Paraja e imët

Paraja e imët duhet të përdoret për raste të shpenzimeve që nuk mund të planifikohen dhe të parashikohen në vlerë më të vogël se 100.00 €.

Për çdo pagesë duhet të bashkëngjiten faturat së bashku me kërkesat e aprovuara, dokumentin e arsyesh mërisë, fletëpranimit standard i parave të imëta.

Të gjitha transaksionet (pagesat) nga paraja e imët janë regjistruar në Llogarinë e parave të imëta. Janë testuar 15 mostra të pagesave nga paraja e imët dhe është vërejtur se iu janë bashkangjitur kërkesat për pagës të faturës, fletëpranimit standard i parave të imëta, faturat (të pa arkivuar) dhe raportin e pranimit të furnizimit/shërbimit me tre anëtar të komisionit.

Shpenzimi i parasë së imtë është shfrytëzuar edhe për shpenzimet që mund të planifikohen dhe që mund të bëhen përmes procedurës së blerjes (blerja e pajisjeve tjera, servisimet, shpenzimet për pastrime dhe për mirëmbajtje).

Pagesat nga paraja e imët për (furnizim për zyre kod ekonomik 13610, shërbime teknike kod ekonomik 13470, pajisje me vlerë të vogël me kod ekonomik 13509, për mirëmbajtje me kod ekonomik 14023), këto shpenzimet janë ekzekutuar edhe nga kodit ekonomike nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Shpenzimet që janë realizuar nga paraja e imët edhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve mundë të ndikojë në përgatitjen e një raporti jo të saktë të shpenzimeve në bazë të kodeve ekonomike.

Konkluzion:

Kërkohet të ngritet niveli i kontrollit të brendshëm që në të ardhmen shpenzimi i parasë së imët të bëhet për shpenzimet e paplanifikuara dhe përmes procedurës së blerjes.

Rekomandim Nr. 5

Pagesat me para të imët të bëhen vetëm për shpenzimet të cilat nuk mund të planifikohen sipas Rregullave financiare dhe Udhëzuesve në fuqi.

3.3.4 Shpenzimet për dreka zyrtare

Bazuar në Rregullën financiare 01/2013 mbi shpenzimin e parasë publike, neni 24, të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit, me ç'rast duhet të sigurohet raporti i pranimi të mallit/shërbimit nga zyrtari/komisioni i autorizuar.

Shpenzimet për dreka zyrtare për Janar-Dhjetor 2021 janë në shume prej 8,317.40 €, ndërsa të planifikuar kane qenë 6,730.00 €. Në të gjitha pagesat e testuara për lëndët për dreka zyrtare nuk është bashkangjitur qëllimi, agjenda dhe lista e pjesëmarrësve, realizimi i shpenzimit për këtë kod ekonomik është tejkaluar në krahasim me të atë planifikuar.

Shpenzimet për dreka zyrtare pa arsytim të qartë dhe të plotë, shton mundësinë që komuna të paguajë për aktivitete që nuk përkojnë me objektivat në komunë.

Rekomandimi Nr. 6

Komuna duhet të ndërmerr masat e nevojshme në mënyrë që shpenzimet e reprezentacionit, të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

3.3.5 Vonesë në pagesat e faturave

Me rregullën financiare 01/2013 sipas Neni 37- pika 1 citohet se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve.

Gjatë ekzaminimit të mostrave të përzgjedhura prej 43 lëndë për testim kemi gjetur se në 14 lëndë ka vonesa në pagesa të faturave.

Ka raste të mbylljes së obligimeve të vitit paraprak, 5 lëndë nga mostrat e përzgjedhura për testim me vlerë prej 47,289.57 €

Janë mbyllur edhe obligimet përmes përmblyesve (vendimeve gjyqësorë) direkt nga thesari, 3 raste të testimit në vlerë prej 48,602.00 €.

Mos pagesa e faturave me kohë mund të sjellë komunën në vështirësi financiare, gjithashtu mund të rezultojë edhe me padi gjyqësore apo pagesa direkt nga thesari.

Mundë të konstatojmë se këto parregullsi kanë ndodhur për shkak se Komuna nuk ka vendosur mekanizma të cilët mundësojnë regjistrimin e faturave të pranuar dhe procedimin me kohë të tyre për pagesë.

Rekomandim Nr.7

Komuna duhet të sigurojë një planifikim të mirëfilltë dhe të drejtë të buxhetit duke pasur parasysh obligimet paraprake dhe realizimin e pagesave sipas afateve ligjore, në mënyrë që t'i shmangët pagesave përmes thesarit.

3.3.6 Subvencionet

Subvencionet janë transfere të njëanshme, të pakthyeshme në llogari rrjedhëse për bizneset private, ndërmarrjet publike, individët etj. Për çdo pagesë të subvencionit apo transferim duhet të ketë bazë të qartë ligjore (Ligj, rregullore, ose vendim të institucionit) që i mundëson organizatës që të bëjë një pagesë nga subvencionet. Pagesat duhet të bëhen përmes transferove bankare. Organizata duhet të mbaj regjistër të detajuar të pagesave, transfereve të bëra dhe kthimeve. Organizata duhet të barazoj këto shuma me raportet bankare dhe me SIMFK. Shpenzimet nga përfituesi duhen të arsyetohen me raport pune dhe dëshmi të plotë të shpenzimeve të kryerjes së aktivitetit.

Për ndarje të subvencioneve si dhe listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve komuna për shkak të transparencës duhet të bëjë publikimin në ueb faqe zyrtare të komunës.

Komuna e Hani të Elezit me datë 30.08.2020 ka nxjerr Rregullën për ndarje të Subvencioneve për kriteret dhe mënyrën e subvencionimit.

Në rregulloren për ndarjen e Subvencioneve janë cekur që ndarjet të bëhet në fusha për: Arsim dhe kulturë, zhvillim ekonomik, bujqësi, shëndetësi dhe mirëqenie sociale si dhe rini dhe sport.

Për të u siguruar se ndarja e subvencioneve a është bërë në mënyrë të drejtë dhe adekuate, duhet të mbahet një regjistër apo një data bazë me të gjitha të dhënat e detajuar dhe hapat e kaluara nga parashtrimi i kërkesës deri te mbulimi me arsyetim të plotë të shpenzimit.

Komuna e Hani të Elezit nuk ka përgatitur dhe mirëmbajtë një evidencë apo regjistër përmbledhëse me të gjitha të dhënat për përfituesit e subvencioneve.

Arsyetimi jo i plotë me dëshmi të shpenzimit mundë të ndikoj që mjetet e dhëna të mos jenë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

Kemi ekzaminuar njëzet e pesë (25) mostra të përzgjedhura. Nga ekzaminimi, analizimi dhe testet e kryera për vitin 2021 dhe 2020 kemi gjetur se Komuna:

- Janë bërë ndarjet e subvencioneve pas shpalljes publike që janë publikuar në web faqen e komunës, media sociale.
- Komuna nuk ka përgatitur Planin vjetor të mbështetjes financiare të Organizatave Jo Qeveritare; (OJQ);
- Nuk është përgatitur Raporti vjetor për projektet e financuara, nuk ishte publikuar në web faqen e komunës lista e përfituesve;
- Janë nxjerr vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve nga kryetari i komunës;
- Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave ka nxjerr listën e përfituesve të subvencioneve. Subvencionet janë ndarë për zhvillim ekonomik, për bujqësi, kulturë rini dhe sport, arsim (bursa studentëve), mbështetje për lehonat etj;
- Në aplikacion të kërkuarit të subvencionit janë paraqit qëllimi për aplikim;
- Në të gjitha rastet e testuar është nxjerr Vendimi për ndarje të subvencioneve përfituesit;
- Nuk janë monitoruar përfituesit e subvencioneve nga Komuna.

Kjo ka ndodhur shkak i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mos zbatimit të kërkesave ligjore për subvencionim.

Mungesa e planeve vjetore pamundëson informimin paraprak të palëve të interesit dhe OJQ-ve. Mos respektimi i rregullave për mbështetjes financiare rritë mundësin e parregullsive gjatë procesit të subvencionimit.

Mungesa e monitorimit të përfituesve të subvencioneve ndikon që projektet të mos zbatohen, rrezikohet që këto mjete mos të shkojnë në destinimin e duhur.

Konkluzion:

Duhet të ngrit nivelin i kontrollit të brendshëm në sigurimin se ndarja e subvencioneve që të bëhet në mënyrë të drejt dhe në fushat ku ka më shumë nevojë për ndarje të subvencionit, në monitorimin dhe bashkëpunimin me përfituesin për subvencionimin e shpenzimeve të dhëna që të sigurohet për të gjitha dëshmitë e plota të shpenzimeve.

Duhet të ngritet niveli i kontrollit të brendshëm për të siguruar që ndarja e subvencioneve është bërë në mënyrë të drejt dhe në fushat ku ka më shumë nevojë për ndarje të subvencionit, duke përgatitur planin vjetor për informim paraprak të palëve të interesuar, në monitorimin dhe bashkëpunimin me përfituesin për subvencionimin e shpenzimeve për të siguruar të dhëna për dëshmitë e plota të shpenzimeve.

Rekomandimi Nr. 8

Kryetari i komunës të marrë masa që subvencionet të monitorohen. Të përgatitet një regjistër në mënyrë të detajuar për të gjitha proceset për ndarje të subvencioneve nga parashtrimi i kërkesës deri te mbulimi me arsyetim të plotë të shpenzimeve. Të përgatitet Plani vjetor i mbështetjes financiare dhe Raporti vjetor për projektet e financuara.

3.3.7 Menaxhimi i kontratave

Menaxhimi siguron procesin dhe procedurat e projektuara nga menaxhmenti për t'u siguruar se kontrolli i brendshëm është ndërtuar dhe po punon në të gjithë komponentët e tij sipas objektivave

të përcaktuara (ambienti i kontrollit, vlerësimi i rrezikut, aktiviteti i kontrollit dhe informacioni e komunikimi).

Pas përfundimit të procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës nga palët, fillon faza e menaxhimit të kontratave që është përcaktuar me LPP. Sipas ligjit parashihet që menaxhimi i kontratave të bëhet në bazë të formularit standard "Planit të menaxhimit të kontratës" duke përfshirë çështjet organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore.

Indikator për matje dhe vlerësim të menaxhimit të kontratave janë: Kontrata e nënshkruar, vendimi i miratuar për caktimin e zyrtarit për menaxhimin e kontratës, kopja e planit të menaxhimit të kontratës (e nënshkruar në pranë me OE), dokumentet përcjellëse të kontratës-garancionet, procesverbalet e takimeve lidhur me menaxhimin e kontratës, progresin e kontratës dhe takimet shqyrtuese, kopjet e të gjitha faturave për punë, shërbime apo furnizime, kopjen e pagesave, raportet e punës së kryer për përmbylljen e kontratës (nëse është arritur qëllimi, objektiva e përcaktuar).

Nga mostrat e testuara të (9) lëndëve për menaxhimin e kontratave nga menaxheret e kontratave kemi gjetur se:

- Menaxherët e kontratës në pesë (5) raste nuk i kanë në dispozicion vendimin e aprovuar nga Zyrtari i Lartë Administrativ për menaxhimin e kontratës;
- Menaxheri i kontratës në (5) raste nuk e kanë në dispozicion kontratën e nënshkruar me OE;
- Menaxherët e kontratës planin e menaxhimit të kontratës e kanë plotësuar dhe kanë dhe kanë në dispozicion në lëndët e menaxhimit të kontratës;
- Menaxhimi i kontratës është përcjellë duke komunikuar me postë elektronike kur është kërkuar nevoja, në (4) raste kanë pasë takime me OE për menaxhimin e kontratës, për të takimet nuk kanë mbajtur procesverbale;
- Kopjet e të gjitha faturave për punë, shërbime apo furnizime në (5) raste nuk janë në dispozicion të menaxheri i kontratës;
- Janë përgatitur raporte pune nga zyrtari i menaxhimit të kontratave në (4) raste për Divizionin e Prokurimit.

Menaxheri i kontratës duhet të mirëmbaj dokumentet complete për funksionim më të mirë të kontrollës në përmbushjen e kontratës në mënyrë fizike apo elektronike në foldere të veçantë për çdo Operator Ekonomike me të cilën është lidhur kontrata e bashkëpunimit me këto dokumente:

Mos mbajtja e plotë e evidencës për ekzekutimin dhe përmbushjen e kontratave ndikon në mos marrjen e informatave kthyesë rreth përmbushjes së kontratave deri te pagesat.

Konkluzion:

Mirëmbajtja dhe kompletimi i dokumenteve në mënyrë fizike apo elektronike për çdo Operator Ekonomik ngritë nivelin të kontrollit në monitorimin dhe mbikëqyrjen e menaxhimit të kontratave në pranim të furnizimit/ punëve/ shërbimeve sipas kërkesave.

Rekomandim Nr. 9

Rekomandohet Menaxheri i kontratës që ta bëjë kompletimin e lëndës së menaxhimit të kontratës në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e LPP.

3.4 Resurset humane, personeli

Menaxhimi i burimeve njerëzore përfshin gjithë procesin nga planifikimi i burimeve njerëzore sipas nevojave në bazë të analizës së nevojave institucionale (përshkrimit të detyrave), planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, buxhetit, planin e rekrutimit, vlerësimin e punës, planin e trajnimit, avancimin në detyrë, shpërblimin me pagë.

Planifikimi i personelit bëhet me qëllim të sigurimit të personelit adekuat me aftësi të nevojshme dhe të domosdoshme për funksionimin e vazhdueshëm të shërbimit civil dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me prioritetet e komunës. Planifikimi i personelit bëhet për nevojat e komunës për arritjen e objektivave të programeve në përputhje me buxhetin e aprovuar. Nga Zyra e burimeve njerëzore është përgatitë Plani vjetor i trajnimeve për nëpunësit civil për periudhën Janar–Dhjetor 2021 sipas nevojave të stafit ku janë parapa dhe janë caktuar prioritetet për trajnime.

Sistemi Informativ të Burimeve Njerëzore (SIBNJ) është duke u përdorur në futjen e të dhënave në sistem dhe është në proces të përcjelljes së rekrutimit.

Dosjet personale të nëpunësve civil krijohet nga Divizioni i Burimeve Njerëzore në formë fizike dhe elektronike, të cilat duhen të ruhen dhe të azhurnohen nga personi i autorizuar i njësisë.

Dosjet personale të nëpunësve civil janë konfidenciale dhe qasja në to është e ndaluar përveç personave të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Qasja e nëpunësit civil në dosjen e tij personale detyrimisht bëhet në praninë e zyrtarit të njësisë së personelit.

Dosjet personale duhet të udhëhiqen në harmoni me Rregulloren e Shërbimit Civil të Kosovës Nr. 03/2011 të cilat përmbajnë: numrin identifikues të secilit punonjës, aplikacionin, akte emërimin, dokumentin e identifikimit, dokumentet mbi arsimimin (Dokumenti i noterizuar apo i vërtetuar nga organi kompetent), dokumentet e komisionit të vlerësimit, përshkrimin e vendit të punës, formularët për pushimet vjetor, mjekësor dhe të dhënat personale të nëpunësit civil.

Në dosje të personelit dokumentet mbi arsimimin që janë të vendosur në dosje të gjitha dhe janë të vërtetuar të organi kompetent.

Dosjet e personelit janë të vendosura në hapësirë adekuate, të mbyllur në mënyrë adekuate, me mundësinë e qasjes së personave të autorizuar, siç i parasheh rregullorja / dosjet e personelit të ruhen në kasaforta metalike.

Dosjet janë të radhitura po jo në baze të listës kontrolluese për të menaxhuar dhe azhurnuar dosjen e personelit.

Shqyrtimi, rishikimi sistematik e Dosjeve të Personelit brenda periudhave të specifikuara duke krijuar edhe listën kontrolluese të dosjes, ndikon në mirëmbajtjen e duhur të dosjeve.

4. KONKLUZIONET

Në përgjithësi ka një sistem të kontrollit, por të gjeturat e auditimit referojnë për ngritjen e nivelit më të lartë të kontrollit prandaj sugjerojmë përgjegjësi dhe llogaridhënie më të lartë të Komunës në menaxhimin e proceseve të administrimit të aktiviteteve në funksionimin në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi, matjen e performancës me realizimin e objektivave.

5. PLANI I VEPRIMIT

Në shkresën për draft raport i dërguar me datë 11.10.2022 është cekur se presim që brenda afatit 10 ditëve nga data e lëshimit të draft raportit të mbajmë një takim për dakordimin e rekomandimeve.

Pas kalimit të afatit kohor, draft raporti finalizohet.

6. FALËNDERIMET

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, ekipit i është ofruar bashkëpunim i mirë nga personat përgjegjës. Ne çmojmë lartë qëndrimin pozitiv dhe besojmë se ky bashkëpunim do të vazhdojë përmes implementimit të rekomandimeve tona.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Auditimit të Brendshëm - Departman Unutrašnje Revizije - Internal Audit
Department

Veprimet e ndërmerrura nga menaxhmenti për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi paraprak **Aneksi I**

Nr.	Rekomandimet	Veprimi i Menaxhmentit	Statusi i rekomandimit I zbatuar / I pa zbatuar Apo në proces
1	Rekomandimi Nr. 1 Kryetari i komunës të marrë masa që subvencionet të monitorohen, të kërkohet raporte nga përfituesit, formati i marrëveshjeve të mos përdoret shabllon por varësisht nga kërkesa e aplikuesit të dihet qartë qëllimi i përfitimit dhe afati kohor i marrëveshjeve.	Subvencionet nuk janë monitoruar, ndërsa raportet nga përfituesit, përdorimi i formatit të marrëveshjeve janë në proces të zbatimit .	Në Proces



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Auditimit të Brendshëm - Department Unutrašnje Revizije - Internal Audit
Department

Të gjeturat dhe rekomandimet për Raportin e auditimit në Komunën e Hani Elezit Aneksi II

NR	TE GJETURAT	REKOMANDIMET	KOMENTET E MENAXHMENTIT	KONKLUZIONET
1	2	3	4	5
1	Që nga viti 2012 kur është nxjerr rregullorja mbi organizimin e brendshëm të komunës nuk ka pasur asnjëherë rifreskim/azhurnim të rregullores, në fakt ka pasur ndryshime dhe lëvizje të strukturës organizative të komunës jashtë strukturave ekzistuese.	Rekomandim Nr.1 Komuna të bëjë azhurnimin e rregullores mbi organizimin e brendshëm të komunës.	Rekomandimi pranohet/nuk pranohet.	Zbatimi i rekomandimeve do të gjurmohet në auditimin përcjellës
2	Nuk kemi gjetur se janë përgatitur raporte periodike nga udhëheqësit e drejtorive dhe njësisive të Komunës për kryetarin, strukturat hierarkike për paraqitjen e realizimit të objektivave dhe sfidat e paraqitura.	Rekomandimi Nr.2 Kryetari i komunës në të ardhmen të siguroj, fuqizoj	Rekomandimi pranohet/nuk pranohet	Zbatimi i rekomandimeve do të gjurmohet në auditimin përcjellës

3	<p>Komuna nuk përgatit apo përdorë një sistem të brendshëm "baza e të dhënave" për menaxhimin të realizimit të shpenzimeve.</p> <p>Në Komunën e Hani të Elezit, realizimi i buxhetit, shpenzimet gjatë vitit 2021 të disa kode ekonomike (13310, 13320, 13440, 13470, 13501, 113509, 13640, 14010, 14032, 14310, 14320, 21200, 31230, 31250, 31690) janë tejkaluar, krahasuar nga kërkesat buxhetore sipas kodeve ekonomike të planifikuara, të paraqitura në formën e PCF4.</p>	<p>zbatimet e funksionimeve të kontrolleve të brendshme në të gjitha proceset</p> <p>Rekomandim Nr.3</p> <p>Planifikimi i buxhetit të bëhet me një analizë, vlerësim më adekuat me nevojat të komunës dhe në harmoni me kodet ekonomike me qëllim të pasqyrimit të saktë për të gjitha shpenzimet sipas rregullave financiare.</p>	<p>Rekomandimi pranohet/nuk pranohet.</p>	<p>Zbatimi i rekomandimeve do të gjurmohet në auditimin përcjellës</p>
4	<p>Për shpenzimet e realizuara, mungojnë kërkesat me arsyezim më të plotë apo të detajuar për iniciimin e furnizimit/shërbimit nga njësia apo zyrtari kërkues, i aprovuar nga udhëheqësi më i lartë administrativ (në të gjitha lëndët):</p> <p>Faturat e pranuar për shërbime dhe furnizime janë arkivuar me vonesë (19 lëndë nga mostra e testuar) ;</p> <p>Ekzistojnë fatura që janë arkivuar por pa datë (4 lëndë nga mostrat e përzgjedhur);</p> <p>Mungon dokumenti i konfirmimit nga menaxheri i kontratës (në të gjitha lëndët);</p> <p>Plani i menaxhimi i kontratës për shpenzime nuk janë bashkangjitur lëndëve;</p> <p>Lëndëve të shpenzimeve nuk iu janë bashkangjitur vendimet e miratuara për menaxhimin e kontratave nga</p>	<p>Rekomandim Nr.4</p> <p>Të bëhet regjistrimi dhe kompletimi i të gjitha lëndëve për shpenzimet e realizuara buxhetore në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Rekomandimi pranohet/nuk pranohet.</p>	<p>Zbatimi i rekomandimeve do të gjurmohet në auditimin përcjellës</p>

5	<p>udhëheqësi me i lartë administrativ (20 lëndëve nga mostrat për testim):</p> <p>Në raportin e pranimit, te formulari i urdhër blerjes mungon përshkrimi i plotë për mallra/shërbimet dhe punën e pranuar sipas kushteve/kërkesave të specifikuara.</p> <p>Pranimi i mallrave dhe shërbimeve është bërë përmes komisionit prej tre anëtarësh, me vendim nga Zyrtari i Lartë Administrativë.</p>	<p>Rekomandim Nr.5</p> <p>Pagesat me para të imët të bëhen vetëm për shpenzimet të cilat nuk mund të planifikohen sipas Rregullave financiare dhe Udhëzuesve në fuqi.</p>	<p>Rekomandimi pranohet/nuk pranohet.</p>	<p>Zbatimi i rekomandimeve do të gjurmohet në auditimin përcjellës</p>
6	<p>Shpenzimi i parashë imët është shfrytëzuar edhe për shpenzimet që mund të planifikohen dhe që mund të bëhen përmes procedurës së blerjes (blerja e pajisjeve tjera, servisimet, shpenzimet për pastrime dhe për mirëmbajtje).</p> <p>Pagesat nga paraja e imët për (furnizim për zyre kod ekonomik 13610, shërbime teknike kod ekonomik 13470, pajisje me vlerë të vogël me kod ekonomik 13509, për mirëmbajtje me kod ekonomik 14023), këto shpenzimet janë ekzekutuar edhe nga kod ekonomike nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.</p>	<p>Rekomandim Nr.6</p> <p>Komuna duhet të ndërmerr masat e nevojshme në mënyrë që shpenzimet e reprezentacionit, të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Rekomandimi pranohet/nuk pranohet.</p>	<p>Zbatimi i rekomandimeve do të gjurmohet në auditimin përcjellës</p>

7	<p>Ka raste të mbylljes së obligimeve të vitit paraprak, 5 lëndë nga mostrat e përzgjedhura për testim me vlerë prej 47,289.57 €</p> <p>Janë mbyllur edhe obligimet përmes përbaruesve (vendimeve gjyqësorë) direkt nga thesari, 3 raste të testimit në vlerë prej 48,602.00 €.</p>	<p>Rekomandim Nr.7</p> <p>Komuna duhet të sigurojë një planifikim të mirëfilltë dhe të drejtë të buxhetit duke pasur parasysh obligimet paraprake dhe realizimin e pagesave sipas afateve ligjore, në mënyrë që t'i shmanget pagesave përmes thesarit.</p>	<p>Rekomandimi pranohet/nuk pranohet.</p>	<p>Zbatimi i rekomandimeve do të gjurmohet në auditimin përcjellës</p>
8	<p>Janë bërë ndarjet e subvencioneve pas shpalljes publike që janë publikuar në web faqen e komunës, media sociale.</p> <p>Komuna nuk ka përgatitur Planin vjetor të mbështetjes financiare të Organizatave Jo Qeveritare; (OJQ);</p> <p>Nuk është përgatitur Raporti vjetor për projektet e financuara, nuk ishte publikuar në web faqen e komunës lista e përfituesve;</p> <p>Janë nxjerr vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve nga kryetari i komunës;</p> <p>Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave ka nxjerr listën e përfituesve të subvencioneve.</p> <p>Subvencionet janë ndarë për zhvillim ekonomik, për bujqësi, kulturë rini dhe sport, arsimit (bursa studentëve), mbështetje për lehonat etj;</p> <p>Në aplikacion të kërkesit të subvencionit janë paraqit qëllimi për aplikim;</p> <p>Në të gjitha rastet e testuar është nxjerr Vendimi për ndarje të subvencioneve përfituesit;</p>	<p>Rekomandimi Nr. 8</p> <p>Kryetari i komunës të marrë masa që subvencionet të monitorohen. Të përgatitet një regjistër në mënyrë të detajuar për të gjitha proceset për ndarje të subvencioneve nga parashtrimi i kërkesës deri te mbulimi me arsyetim të plotë të shpenzimeve. Të përgatitet Plani vjetor i mbështetjes financiare dhe Raporti vjetor për projektet e financuara.</p>	<p>Rekomandimi pranohet/nuk pranohet.</p>	<p>Zbatimi i rekomandimeve do të gjurmohet në auditimin përcjellës</p>

9	<p>Nuk janë monitoruar përfituesit e subvencioneve nga Komuna.</p> <p>Menaxherët e kontratës në pesë (5) raste nuk i kanë në dispozicion vendimin e aprovuar nga Zyrtari i Lartë Administrativ për menaxhimin e kontratës;</p> <p>Menaxheri i kontratës në (5) raste nuk e kanë në dispozicion kontratën e nënshkruar me OE;</p> <p>Menaxherët e kontratës planin e menaxhimit të kontratës e kanë plotësuar dhe kanë dhe kanë ne dispozicion në lëndët e menaxhimit të kontratës;</p> <p>Menaxhimi i kontratës është përcjellë duke komunikuar me postë elektronike kur është kërkuar nevoja, në (4) raste kanë pase takime me OE për menaxhimin e kontratës, për të takimet nuk kanë mbajtur procesverbale;</p> <p>Kopjet e të gjitha faturave për punë, shërbime apo furnizime në (5) raste nuk janë në dispozicion të menaxheri i kontratës;</p> <p>Janë përgatitur raporte pune nga zyrtari i menaxhimit të kontratave në (4) raste për Divisionin e Prokurimit.</p>	<p>Rekomandim Nr.9</p> <p>Rekomandohet Menaxheri i kontratës që ta bëjë kompletimin e lëndës së menaxhimit të kontratës në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e LPP.</p>	<p>Rekomandimi pranohet/huk pranohet.</p>	<p>Zbatimi i rekomandimeve do të gjurmohet në auditimin përcjellës</p>
---	---	---	---	--

Aneksi nr 3

Emri i Auditimit: Funksionimi i kontrollit të brendshëm, planifikimi dhe administrimi i buxhetit në komunën e Hani Elezit

Plani i Veprimit

Nr.	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar për përfundim	Personi përgjegjës	Zbatimi i rekomandimeve
1	Rekomandim Nr.1 Komuna të bëjë azhurnimin e rregullores mbi organizimin e brendshëm të komunës.				
2	Rekomandimi Nr.2 Kryetari i komunës në të ardhmen të siguroj, fuqizoj zbatimet e funksionimeve të kontrolleve të brendshme në të gjitha proceset				
3	Rekomandim Nr.3 Planifikimi i buxhetit të bëhet me një analizë, vlerësim më adekuat me nevojat të komunës dhe në harmoni me kodet ekonomike me qëllim të pasqyrimit të saktë për të gjitha shpenzimet sipas rregullave financiare.				

4	<p>Rekomandim Nr.4</p> <p>Të bëhet regjistrimi dhe kompletimi i të gjitha lëndëve për shpenzimet e realizuara buxhetore në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.</p>				
5	<p>Rekomandim Nr.5</p> <p>Pagesat me para të imët të bëhen vetëm për shpenzimet të cilat nuk mund të planifikohen sipas Rregullave financiare dhe Udhëzuesve në fuqi.</p>				
6	<p>Rekomandimi Nr.6</p> <p>Komuna duhet të ndërmerr masat e nevojshme në mënyrë që shpenzimet e reprezentacionit, të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.</p>				
7	<p>Rekomandim Nr.7</p> <p>Komuna duhet të sigurojë një planifikim të mirëfilltë dhe të drejtë të buxhetit duke pasur parasysh obligimet paraprake dhe realizimin e pagesave sipas afateve ligjore, në mënyrë që t'i shmanget pagesave përmes thesarit.</p>				

8	Rekomandimi Nr. 8 Kryetari i komunës të marrë masa që subvencionet të monitorohen. Të përgatitet një regjistër në mënyrë të detajuar për të gjitha proceset për ndarje të subvencioneve nga parashtrimi i kërkesës deri te mbulimi me arsyetim të plotë të shpenzimeve. Të përgatitet Plani vjetor i mbështetjes financiare dhe Raporti vjetor për projektet e financuara.				
9	Rekomandim Nr.9 Rekomandohet Menaxheri i kontratës që ta bëjë kompletimin e lëndës së menaxhimit të kontratës në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e LPP.				